



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 89, datë 28.04.2022

**PËR
MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 79,
DATË 31.08.2015 “PËR MIRATIMIN/LICENCIMIN E PERSONAVE PËR TË
USHTRUAR VEPRIMTARINË E AGJENTIT NË SIGURIME, SI DHE RASTET E
MOSPRANIMIT TË REGJISTRIMIT TË TIJ DHE REFUZIMIT TË LICENCËS”, E
NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

Në Rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, miratohen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 6, pika 1, pas germës “j”, shtohet germa j/1 me këtë përmbajtje:

“Dokument bankar që vërteton pagimin në llogari të ndara të garancisë financiare, kur shoqëria e agjentëve do ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime për jetë dhe jo jetë”.

2. Në nenin 9, pas pikës 1, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Në rast se subjekti kërkon të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime jetë dhe jo jetë, ose kur është miratuar për ushtrim veprimtari sigurimi të jetës dhe kërkon edhe për jo jetë ose anasjelltas, duhet që veprimtaritë të jenë të ndara veçmas. Kërkesa me shkrim, sipas formë kërkesës në aneksin 3, të kësaj rregulloreje, shoqërohet me:

- a. Vendimin e miratimit nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari agjenti në sigurime (jetë dhe jo jetë);*
- b. Të dhëna për strukturat/njësitë, organigrama, që do kryejë veprimtarinë e agjentit në sigurime veçmas për jetë dhe jo jetë, si edhe rregulla për organizimin dhe funksionimin e secilës strukturë;*
- c. Rregullat për raportimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime të jenë veçmas për jetë dhe jo jetë;*
- d. Lista e agjentëve të punësuar dhe dokumentacioni përkatës i tyre në përmbushje të kërkesave të nenit 3 të kësaj rregulloreje, të jenë veçmas për jetë dhe jo jetë;*
- e. Rregullat e brendshme që duhet të përmbajnë politikat dhe/ose procedurat për:
 - i. Mënyrën e informimit të klientëve dhe trajtimit të ankesave veçmas për jetë dhe jo jetë;*
 - ii. Mënyrën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, kur kërkon të ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime të jetës;**
- f. Kopje të marrëveshjeve me shoqëritë e sigurimit, në emër dhe për llogari të të cilave do të ushtrojnë veprimtarinë e agjentit në sigurime të jetës dhe jo jetës;*
- g. Dokumentet që vërtetojnë pagesën e tarifës për depozitim dhe shqyrtim dokumentacioni sipas Rregullores nr. 155, datë 23.12.2014, e ndryshuar”.*

3. Në nenin 16, pika 1, pas germës “b”, shtohet germa “c” me këtë përmbajtje:

“Kur subjekti financiar jo bankë do ushtrojë veprimtarinë e agjentit në sigurime për jetë dhe jo jetë, depoziton dokumentin bankar që vërteton depozitimin në llogari të ndara qëllimore të garancisë financiare”.

4. Në nenin 18, pika 1, shkronja “a”, ndryshon si më poshtë:

“a. Të përdorë, për transferimin e parave (primeve) nga konsumatori tek shoqëria e sigurimit, llogari bankare të veçanta për veprimtarinë e jetës dhe jojetës, të hapura për këtë qëllim nga shoqëria e sigurimit, në një nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, llogari bankare mbi të cilat nuk ka asnjë të drejtë”.